



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Administratës**

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. K3/H3-26 Prot.

Tiranë 21/12/2021

Nr. Dok. 202100374 /26

Lënda: *Rekomandim për trajtimin e rastit të shtetases H.GJ.*

Drejtuar: BASHKISË TIRANË

TIRANË

**INSPEKTORIATIT TË MBROJTJES SË TERRITORIT
PRANË BASHKISË**

TIRANË

**Për dijeni: INSPEKTORIATIT KOMBËTAR TË MBROJTJES SË
TERRITORIT**

TIRANË

Të nderuar !

Pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, është regjistruar ankesa e znj. H.GJ, ndaj Bashkisë së Tiranës. Në ankesën e saj kjo shtetase ndër të tjera ka parashtruar se: “.....Ajo është banore e qytetit të Tiranës. Prej tridhjetë vjetësh jeton në një bodrum të ndodhur në adresën: Bulevardi: “Zogu i Parë”, pallati 64, shkalla 1,

Njësia Bashkiake Nr 9,Tiranë. Ky bodrum ka patur dy dritare të vogla. Ankuesja pretendon se njëra prej dritareve të bodrumit i është mbyllur dy vjet më parë, pasi i janë vendosur shkallë mbi të, nga ana e zyrës noteriale e cila gjendet në katin e parë, mbi bodrumin e saj. Edhe pse është ankuar disa herë për mbylljen e kësaj dritareje që ajo ka patur në pjesën anësore të pallatit, nuk ka gjetur zgjidhje dhe për pasojë njëra prej dritareve të bodrumit të saj qëndron e mbyllur prej rreth dy vjetësh. Në ankesën e saj kjo shtetase ankohet lidhur me faktin se edhe dritarja e vetme nga e cila merr dritë bodrumi i saj, po i bllokohet përsëri me shkallë nga fqinji i saj i katit të parë, që ndodhet mbi të, (aktualisht zyrë noteriale), e cila ka prishur dritaren e ambjenteve të tij në katin e parë, dhe e ka kthyer në derë pa marrë leje tek Bashkia Tiranë si dhe ka vendosur shkallë mbi dritaren e bodrumit të saj. Vendosja e këtyre shkallëve aktualisht e cënon atë pasi aktualisht i pengojnë dritën dhe ajrimin e bodrumit, i cili asaj i shërben për banim. Ajo sqaron se kur është bërë projekti i fasadës së pallatit nga ana e Bashkisë së Tiranës, i kanë thënë se dritarja e bodrumit të saj është e përjashtuar nga ky projekt, e për pasojë të gjitha veprimet e mësipërme janë kryer pa marrë lejen përkatëse tek Bashkia Tiranë”.

Ankuesja pretendon se është ankuar pranë Bashkisë Tiranë, lidhur me cënimin e të drejtës së saj të pronësisë, si pasojë e kryerjes së ndërtimit të paligjshëm, por nuk ka marrë asnjë përgjigje prej saj. Ndodhur në këto kushte i është drejtuar institucionit tonë për ndërhyrje dhe zgjidhjen e situatës së krijuar.

Pas regjistrimit të kësaj ankese, Avokati i Popullit, i ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për garantimin e mbrojtjes së të drejtave, lirive themelore dhe interesave të shtetasve nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, ka konstatuar se ankesa plotëson të gjithë kushtet thelbësore si në aspektin formal dhe atë substancial për t’u konsideruar në kompetencën e tij lëndore, ndaj bazuar në ligjin

Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, respektivisht nenet 13,17/a dhe 18/b, ka vendosur t’a pranojë ankesën dhe të fillojë procedurën e shqyrtimit të çështjes.

Në vijim në lidhje me sa sipër, ankuesja ka shpjeguar se më datë 26.03.2021, nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë është konstatuar në vend situata dhe është mbajtur proces-verbali përkatës ”Për konstatimin e kundravajtjes me Nr 4032, datë 26.03.2021” (Nr serial 004032). Nga vlerësimi i situatës është konstatuar zgjerimi i dritares nga fqinji i saj i katit të parë z. N.N, (ambjent ky i cili shërben si zyrë noteriale dhe jo për banim), si dhe vendosja e një shkalle me konstruksion metalik të çmontueshëm.

Sa më sipër, ankuesja ka kërkuar ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit për shqyrtimin dhe verifikimin e kësaj çështjeje me qëllim të mbrojtjes sa më efektive të të drejtave dhe interesave të saj të ligjshme, dhe kërkon heqjen e shkallëve me konstruksion metalik të çmontueshëm, të vendosura mbi dritaren e bodrumit ku ajo banon dhe që i pengojnë dritën dhe ajrimin e bodrumit, pasi efektivisht fqinji i saj (zyra noteriale nuk i përdor këto shkallë), pasi ka funksionale shkallë te tjera me konstruksion të qëndrueshëm në pjesën anësore të pallatit që përkojnë edhe me derën ekzistuese hyrëse të zyrës.

Qëndrimi i Bashkisë së Tiranës, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Tiranë, dhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit , lidhur me rastin .

Për shqyrtimin me objektivitet të kësaj çështje dhe për të mundësuar një hetim të plotë administrativ, në vështrim të nenit 63, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku përcaktohet se: “Organet dhe funksionarët publikë janë të detyruar t’i paraqesin Avokatit të Popullit të gjitha dokumentat dhe

informacionet e kërkuara prej tij, si dhe në nenin 19/b të ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” i ndryshuar, në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë: b) të kërkojë shpjegime nga çdo organ i administratës qendrore dhe vendore, si dhe të marrë çdo dosje apo material që ka lidhje me hetimin”*, me tonën Nr. K3/H3-2 prot., datë 18.03.2021, dhe Nr. K3/H3-3 prot., datë 18.03.2021, kemi kërkuar përkatësisht nga Bashkia Tiranë dhe Njësia Administrative, Njësia Bashkiake Nr 9 Tiranë, dhënien e shpjegimeve dhe të informacionit nëse qëndrojnë pretendimet e ankueses si dhe mundësinë e zgjidhjes së problematikave të saj.

Me shkresën Nr. K3/H3-5 prot., datë 26.03.2021, Njësia Administrative, Nr. 9 Tiranë, në përgjigje të shkresës sonë me Nr. K3/H3-3 prot., datë 18.03.2021, me objekt: *“kërkesë për shpjegime”* lidhur me ankesën e shtetases H.GJ, na ka informuar ndër të tjera se: *“Bashkia Tiranë po rehabiliton Bulevardin “Zogu I” dhe fasadat përgjatë tij, pjesë e së cilës janë edhe unifikimi i bizneseve të kateve të para. Pas ankesës së znj. Gjella, Njësia Administrative Nr 9 Tiranë, i është drejtuar me shkresë Nr 323/1 prot., datë 27.01.2021, Bashkisë Tiranë, si organi kompetent që ka miratuar projektin e rehabilitimit të Bulevardit “Zogu I” dhe fasadave përgjatë tij.”* Bashkëlidhur kësaj shkrese ka dërguar edhe ankesën e znj H.GJ., Nr. 323 prot., datë 22.01.2021, dhe shkresën Nr. 323/1 prot., datë 27.01.2021, drejtuar Bashkisë Tiranë.

Me shkresat Nr. K3/H3-8 prot., datë 04.05.2021, dhe Nr. K3/H3-9 prot., datë 10.05.2021, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike, Drejtoria e Investimeve Publike, në përgjigje të shkresës me Nr K3/H3-2 prot., datë 23.03.2021, me objekt: *“kërkesë për shpjegime”* si dhe me shkresën Nr K3/H3-6 prot., datë 29.04.2021, me objekt: *“kërkesë e përsëritur për shpjegime”*, lidhur me ankesën e shtetases H.GJ., banuese në një bodrum të pallatit 64, të ndodhur në Bulevardin “Zogu I-rë”, në të dyja këto shkresa ka shpjeguar se: *“Fasada e*

këtij pallati është pjesë e projektit “Rehabilitimi i Bulevardit “Zogu I-rë”, i cili ndërmjet punimeve të tjera përfshin edhe rehabilitimin e fasadave, pjesë e së cilës janë edhe shkallët e ambjenteve të shërbimit të katit të parë, të cilat po ndërtohen të gjitha të unifikuara me pllaka guri, duke lënë hapësirë ndërmjet tyre për t'i dhënë ndriçim edhe bodrumeve. Pjesë e këtij projekti janë edhe ambjentet e shërbimit të katit të parë të pallatit 64, të cilat po ndërtohen me të në të njëjtin projekt. Përsa i përket dritares së bodrumit të znj. H.GJ, ju bëjmë me dije se kjo e fundit jo vetëm që nuk është mbyllur, por është e sistemuar me kangjella hekuri.”

Ndërsa me shkresën Nr. K3/H3 -11 prot., datë 20.05.2021, “*Kthim përgjigje*” të Bashkisë Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licensimit Drejtoria Juridike, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative dhe Emergjencave Civile, si dhe për dijeni Avokatin e Popullit, ka sqaruar se: “*Pranë Drejtorisë së Përgjithshme Juridike të Aseteve dhe Licensimit, është paraqitur shkresa juaj me Nr 12365/6 prot., datë 05.05.2021, nëpërmjet së cilës përcillni moskompetencën për trajtimin e rastit të zonjës H.GJ., banesa e së cilës është përjashtuar nga zbatimi i projektit të Bashkisë Tiranë në fasadën e pallatit ku ajo banon. Me vendimin Nr 39 datë 03.05.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e programit “Fondi Komuniteteve”, hartuar sipas udhëzuesit operacional për zbatimin e tij”, i cili ka për qëllim nxitjen e bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe Bashkisë së Tiranës duke krijuar një skemë efektive bashkë-financimi me qëllim përmirësimin e ambienteve në bashkëpronësi, pika 2, nënpika 2.3, është parashikuar se një ndër llojet e projekteve të kualifikueshme për bashkëfinancim është mirëmbajtja e fasadave ku përfshihen lyerja dhe suvatim fasadash, etj. Gjithashtu referuar Vendimit Nr 48492 datë 20.12.2019 të Këshillit Bashkiak “Për miratimin e rregullores për organizimin, funksionimin, detyrat dhe përgjegjësitë e administratës së aparatit të Bashkisë Tirranë, Drejtoria e Përgjithshme e*

Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative, dhe Emergjencave Civile është përgjegjëse për mirëmbajtjen fizike të mjediseve të brendshme dhe fasadave. Për sa sipër, në cilësinë e strukturës përgjegjëse, lutemi të vijoni me trajtimin e rastit të zonjës H.G.J. mbi përjashtimin e banesës së saj nga projekti i Bashkisë Tiranë në fasadën e pallatit ku banon dhe në përfundim t'i vendosni në dispozicion informacionin e kërkuar institucionit të Avokatit të Popullit.

Në vijim të kësaj korrespondence me shkresën Nr. K3/H3-12 prot., datë 09.06.2021, “kthim përgjigje”, Bashkia Tiranë, Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative, dhe Emergjencave Civile, “Në përgjigje të shkresës me Nr. Prot. 12365/12, datë 18.05.2021, nga Drejtoria e Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, në vijim të shkresave me Nr. prot 12365/1, datë 07.04.2021, Nr. prot. 12365/2, datë 14.04.2021, nga Drejtoria e sipërcituar dhe shkresave me Nr. prot. K3/H3-2, datë 18.03.2021, Nr. Prot .K/3H3-6, datë 22.06.2021 dhe Nr. prot K3/H3-7, datë 27.04.2021 nga Avokati i Popullit”, në bazë të ligjit Nr 10112 datë 09.04.2009, “Për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit” si dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij ka informuar se “Objektet e përbashkëta të bashkëpronarëve të ndërtesave: trualli mbi të cilin është ngritur ndërtesa, themelet, muret kryesore, muret ndarëse të brendshme, shkallët, hollet, çatia ose taraca, oxhaqet, si edhe të gjitha ato objekte të ndërtesës, që kanë karakter të tillë dhe shërbejnë për përdorim të përbashkët, mirëmbahen nga vetë bashkëpronarët. Ansambleja e bashkëpronarëve merr vendim për mënyrën e administrimit të bashkëpronësisë, miraton kriteret, kostot e administrimit, mënyrën e kohën e pagesës së saj për secilin bashkëpronar. Bashkia e Tiranës bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak Nr 39, datë 03.05.2019, për të mbështetur komunitetin në administrimin e mjediseve të përbashkëta ka miratuar “Fondi i Komuniteteve”, ku nëpërmjet nje skemë fondesh të vëna në dispozicion nga Bashkia e Tiranës

banorët e lagjeve të ndryshme (bashkëpronarët e ambjenteve të banimit) të kryeqytetit mund të organizohen së bashku në udhëheqjen e Administratorëve për të përfituar bashkë-financim për projekte infrastrukturore, të cilat adresojnë një problem të caktuar në komunitetin e tyre. Përsa më sipër ju mund të aplikoni në programin: "Fondi i Komuniteteve" me një projekt të kualifikueshëm për investim.

Sa sipër është mëse evidente që kthimi i përgjigjes sa sipër ka dhënë një informacion të përgjithshëm që ka të bëjë me faktin se si znj. Hane Gjella mund të aplikojë në programin: "Fondi i Komuniteteve", me një projekt të kualifikueshëm për investim, por që nuk ka lidhje fare me objektin e kërkesës së dërguar nga institucioni ynë, që konsistonte në dhënien e informacionit : për përjashtimin ose jo të bodrumit të znj. H.GJ., (në të cilin ajo banon), nga projekti i Bashkisë Tiranë.

Veç sa sipër, gjithashtu sjellim në vëmendje se në dhënien e kësaj përgjigjeje nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Objekteve në Bashkëpronësi, Administrimit të Njësive Administrative, dhe Emergjencave Civile, nuk është patur në konsideratë edhe qëndrimi i mbajtur nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme Juridike, Aseteve dhe Licencimit, të Bashkisë Tiranë, në shkresën Nr prot., 12365/12, datë 18.05.2021, në të cilën ndër të tjera i ka kërkuar që : ... *Në cilësinë e strukturës përgjegjëse, të vijojë me trajtimin e rastit të zonjës H.GJ. mbi përjashtimin e banesës së saj nga projekti i Bashkisë Tiranë në fasadën e pallatit ku banon dhe në përfundim ti vendosë në dispozicion informacionin e kërkuar Institucionit të Avokatit të Popullit.*

Në këto kushte për të hetuar mbi faktin e lartëpërmendur, ju jemi drejtuar sërish me shkresën Nr. K3/H3-14 prot., datë 16.06.2021, dhe kemi rikërkuar që duke ju referuar projektin të Bashkisë Tiranë për "Rehabilitimin e Bulevardit "Zogu I-

rë”, të na shpjegoni në mënyrë ezauruese nëse bodrumi ku banon shtetësja H.GJ. është përjashtuar nga zbatimi i këtij projekti në fasadën e pallatit ku ajo banon, si dhe po sipas këtij projekti a janë të parashikuara vendosja e shkallëve në pjesën e fasadës së pallatit që i përket në mënyrë të specifikuar apartamentit të katit 0 teknik, i cili pozicionohet mbi bodrumin ku banon ankuesja H.GJ.? (bashkëngjitur ju kemi dërguar foto të objektit për ta identifikuar më lehtë) . Në referim të nenit 19 të Ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar ku parashikohet se: “Avokati i Popullit ka të drejtë të caktojë një afat për kryerjen e veprimeve të mësipërme”, kemi kërkuar që informacioni i kërkuar të na vihet në dispozicion brenda një afati prej 10 (dhjetë) ditësh nga marrja e kësaj shkrese.

Me shkresën Nr K3/3H3-19 prot., datë 20.07.2021 “dërgim informacioni”, (më shumë se një muaj më pas) , Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike, Bashkia Tiranë ka sqaruar në mënyrë përfundimtare se: *“Projekti i objektit “Rehabilitimi i Bulevardit Zogu I-rë” ka pasur si qëllim ndër të tjera edhe unifikimin e fasadave të objekteve të ndodhura në të dy anët e Bulevardit, ku edhe fasada e jashtme e pallatit 64 është pjesë e këtij projekti. Rehabilitimi i fasadave në të dy anët e bulevardit, përfshin rehabilitimin e fasadave dhe shkallëve të ambjenteve të shërbimit të katit të parë, me qëllim unifikimin e tyre. Ju bëjmë me dije se trajtimi i dritareve të bodrumeve të këtij objekti nuk ishte pjesë e projektit e si të tilla edhe dritaret e bodrumit të znj. H.GJ.. Gjithashtu sqarojmë se shkallët e ndërtuara me konstruksion metalik nuk janë realizuar nga ky projekt, pasi nuk kanë qenë pjesë e tij. Unifikimi i shkallëve që parashikohej nga ky projekt realizohej me beton dhe pllaka guri si këmbë shkelje. “*

Në funksion të këtij hetimi administrativ, me shkresën Nr. K3/H3-7 prot., datë

27.04.2021, “Kërkesë për informacion”, i jemi drejtuar edhe Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Tiranë, të cilit i kemi kërkuar një informacion konkret dhe gjithëpërfshirës, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor që ka të bëjë me çështjen e parashtruar sa sipër, si dhe të na informojë në lidhje me vazhdimin e mëtejshëm të procedurave ligjore pas njoftimit që inspektorët e Inspektoriatit Vendor, i kanë bërë K/Inspektorit në lidhje me rastin . *(bashkëlidhur është dërguar kopje e proces-verbalit “Mbi konstatimin e kundërvajtjes” Nr 0004032 datë 26.03.2021).*

Inspektoriatit i Mbrojtjes së Territorit Bashkia Tiranë, me shkresën Nr K3/3H3-10 prot., datë 19.05.2021, “*kthim përgjigje*”, drejtuar Avokatit të Popullit dhe për dijeni Bashkisë Tiranë, Drejtorit të Kabinetit, ka informuar se :“ *Inspektorët e IMT-së , Bashkia Tiranë për rastin në fjalë kanë vepruar konform Ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme”, (i ndryshuar), Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014, ”Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (i ndryshuar), V.K.M Nr. 408, datë 13.05.2015, ”Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit (i ndryshuar), V.K.M Nr. 894, datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të Territorit nga Inspektoriatit Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektoriatit Vendor i Mbrojtjes së Territorit”. Gjatë kontrollit të ushtruar në Bulevardin “Zogu i Parë”, pallati 64, shkalla 1, për kundërvajtjen e konstatuar ”zqjerimi i dritares si dhe vendosja e një shkalle me konstruksion metalik i çmontueshëm pa u pajisur me leje përkatëse” IMT, Bashkia Tiranë ndaj shtetasit N.N ka mbajtur procedurën e parashikuar ligjore: proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes Nr. 4032 datë 26.03.2021 dhe vendim për dënimin me gjobë Nr. 3338, datë 02.04.2021. Bashkëlidhur janë dërguar kopje të vendimeve të sipërcituar dhe një foto.*

Pas përgjigjes së ardhur meqenëse nga aktet e sipërcituara rezultoi se lidhur me rastin në fjalë ju keni konstatuar kundërvajtjen administrative të kryer nga ana e shtetasit N.N, për shkak se ka kryer punime pa u pajisur me leje përkatëse për zgjerimin e dritares, si dhe vendosjen e një shkalle me konstruksion metalik të çmontueshëm, dhe keni vendosur gjobë në masën 50 000 lekë për kundërvajtësin, i jemi ridrejtuar me shkresën Nr.K3/H3-13 prot., datë 16.06.2021, IMT-së, të na dërgojë një informacion shterues, duke shtruar për sqarim çështjet e mëposhtme:

- *Është patur në konsideratë nga ana juaj fakti që kundërvajtësi ka kryer punime pa leje jo vetëm për zgjerimin e dritares, por edhe e ka kthyer atë në derë dhe për pasojë për ta përdorur dhe patur funksionale atë si derë ka bërë edhe vendosje pa lejë të shkallëve me konstruksion metalik të çmontueshëm ? (ju kemi dërguar bashkëngjitur edhe foto të objektit) .*

- *Në kuptim të ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007, të ndryshuar, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i cili ka për qëllim ndër të tjera mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, na shpjegoni nëse vendosja e gjobës dhe vjelja e saj e rikthejnë situatën në kushtet e ligjshmërisë ?*

- *Në këtë kontekst a është në tagrin e ushtrimit të detyrave tuaja prishja (heqja) e shkallëve ose konfiskimi i tyre? Nëse po na informoni se ç’farë masash keni ndërmarrë konform ligjit për prishjen e shkallëve të vendosura në mënyrë të kundërligjshme me qëllim lirim të hapësirës publike ?*

- *A ka patur bashkërendim të veprimeve midis IMT dhe Policisë Bashkiake Tiranë, në lidhje me këtë rast ?*

Në vështrim të nenit 51 të ligjit Nr 107/2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “*Inspektimi ka për mision garantimin dhe mbrojtjen e interesit kombëtar për një zhvillim të drejtë dhe të qëndrueshëm të territorit, përmes parandalimit të punimeve dhe ndërtimeve të paligjshme, sipas këtij ligji dhe akteve të nxjerra në zbatim të tij, si dhe ndëshkimit të drejtë*

të kundërvajtësve, që shkelin dispozitat e këtij ligji si dhe të nenit 9/b të ligjit Nr 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, të ndryshuar: “Përgjegjësitë e Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit”, ku parashikohet se: ”Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit, nëpërmjet kryeinspektorit dhe inspektorëve, ushtron këto detyra dhe përgjegjësi: b) kontrollon zbatimin e dispozitave të këtij ligji nga Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit të njësisë në nivel të qeverisjes vendore, i jemi drejtuar edhe Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit.

Me shkresën Nr K3/H3-15 prot., datë 05.07.2021 “Inspektoriat Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, i ka kërkuar informacion Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Tiranë, dhe ka vënë në dijeni Drejtorinë Rajonale të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit – Tiranë, si dhe Avokatin e Popullit, që “Në zbatim të përgjegjësisë dhe detyrave që ngarkon Ligji Nr 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” (i ndryshuar), V.K.M Nr 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të Territorit nga Inspektoriat Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njësisë Vendore, Ligjin Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, V.K.M Nr. 408, datë 13.05.2015”, Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit (i ndryshuar), dhe i ka kërkuar informacion të plotë në lidhje me veprimet e kryera si dhe zbatimin e ligjshmërisë deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes. Në përfundim për çfarë konkludohet brenda afateve të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit Nr 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i ndryshuar të dërgohet informacion pranë Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Avokatit të Popullit.”

Me shkresën Nr. K3/3H3-16 prot., datë 12.07.2021 “kthim përgjigje”, Inspektoriat i Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Tiranë, në përgjigje të shkresës

sonë me Nr. K2/H3-14 prot., datë 16.06.2021, në lidhje me informacionin e kërkuar për shtetasen H.GJ. ka bërë me dije se: *“Inspektorët e IMT, Bashkia Tiranë për rastin në fjalë kanë vepruar konform Ligjit Nr 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” (i ndryshuar), Ligjit Nr. 107/2014, datë 31.07.2014”Për planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit (i ndryshuar), V.K.M Nr. 408, datë 13.05.2015,”Për miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit (i ndryshuar), V.K.M Nr. 894, datë 04.11.2015, “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të Territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Territorit”. Në vijim të korrespondencës sonë sikurse keni cilësuar edhe në shkresën tuaj Bashkia Tiranë ka rehabilituar Bulevardin “Zogu I-rë”, dhe fasadat përgjatë tij, pjesë e së cilës është edhe unifikimi i bizneseve të kateve të para, si dhe kthim përgjigje të kërkesës për shpjegime lidhur me ankesën e shtetasës H.GJ., banuese në bodrumin e pallatit 64, të ndodhur në Bulevardin “Zogu I-rë:”Fasada e këtij pallati është pjesë e projektit “Rehabilitimi i Bulevardit “Zogu I-rë”, i cili ndërmjet punimeve të tjera përfshin edhe rehabilitimin e fasadave, pjesë e së cilës janë edhe shkallët e ambjentëve të shërbimit të katit të parë, të cilat po ndërtohen të gjitha të unifikuara me pllaka guri, duke lënë hapësirë ndërmjet tyre për t’i dhënë ndriçim edhe bodrumeve. Pjesë e këtij projekti janë edhe ambjentet e shërbimit të katit të parë të pallatit 64, të cilat po ndërtohen në të, në të njëjtin projekt. Gjatë kontrollit të ushtruar në Bulevardin “Zogu i Parë”, pallati 64, shkalla 1, është konstatuar se shtetasi N.N ka kryer punime që konsistojnë në ”zgjerimi i dritares si dhe vendosja e një shkalle me konstruksion metalik i çmontueshëm pa u pajisur me dokumentacionin përkatës tekniko-ligjor në momentin e inspektimit apo leje përkatëse nga organet përgjegjëse”, Inspektoriati Mbrojtjes së Territorit Bashkia Tiranë ndaj shtetasit N.N ka mbajtur procedurën e parashikuar ligjore:Proces-verbal për konstatimin e kundërvajtjes Nr 4032 datë 26.03.2021,
Vendim për dënimin me gjobë Nr 3338 datë 02.04.2021*

Meqenëse në këtë shkresë, është konstatuar se shpjegimet e dhëna nga ana IMT-së, nuk kanë qenë ezauruese, pasi nuk i kanë dhënë përgjigje çështjeve të parashtruara nga ana jonë si më sipër, por thjesht ka një përsëritje të informacionit të dhënë në shkresat e mëparshme, i cili për pasojë nuk ndihmon në sqarimin më tej të situatës, në vijim, ju jemi ridrejtuar në mënyrë të përsëritur me shkresën Nr. K3/H3-18 prot., datë 15.07.2021, (si edhe IKMT-së), që të na dërgoni një informacion sa më konkret, si dhe dokumentacionin përkatës ligjor që ka të bëjë me dhënien e përgjigjeve të pyetjeve të specifikuara sa sipër.

Me shkresën Nr. K3/H3-20 prot., datë 06.08.2021, Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, në përgjigje të shkresës sonë me Nr. K3/H3-18 prot., datë 15.07.2021, me objekt: *“kërkesë e përsëritur për informacion”*, lidhur me ankesën e shtetases H.GJ., banuese në një bodrum të pallatit 64, të ndodhur në Bulevardin “Zogu I-rë”, ***(për dijeni edhe IMT-së, Bashkisë Tiranë)***, ka shpjeguar ndër të tjera se: *“Sikurse jeni në dijeni për rastin dhe keni mbajtur procedurë ligjore përkatësisht proces-verbal konstatimi Nr 4032 datë 26.03.2021 dhe vendim për dënim me gjobë Nr 3338 datë 02.04.2021, por deri më datë 16.06.2021, shkallët rezultojnë të pahequra. Sa sipër në zbatim të përgjegjësiave dhe detyrave që ju ngarkon ligji Nr 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme” i ndryshuar, V.K.M Nr. 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, dhe ai i njësisë vendore, ligjin 107 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, VKM 408 datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit” e ndryshuar, rikërkojmë nga ju informacion të plotë në lidhje me veprimet e kryera si dhe zbatimin e ligjshmërisë deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje. Në përfundim, për çfarë konkludohet, brenda afateve të përcatuara në nenin 5 të ligjit Nr 9780 datë 16.07.2007, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e*

territorit nga ndërtimet e paligjshme”, i ndryshuar, të dërgohet informacion pranë Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Avokatit të Popullit”

Me shkresën Nr. K3/H3-22 prot., datë 30.08.2021, dhe Nr K3/H3-24 prot., datë 11.10.2021, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit në përgjigje të shkresës sonë me Nr. K3/H3-18 prot., datë 15.07.2021, dhe Nr. K3/3H3-23 prot., datë 07.09.2021, me objekt: *“kërkesë e përsëritur për informacion”,* lidhur me ankesën e shtetases H.GJ., ka shpjeguar ndër të tjera se : *Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Bashkia Tiranë për rastin në fjalë ka vepruar konform Ligjit Nr. 9780 datë 16.07.2007, ”Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme“, i ndryshuar, Ligjit Nr 107/2014, datë 31.07.2014, “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” (i ndryshuar), V.K.M Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e Rrregullores së Zhvillimit të Territorit, (i ndryshuar), V.K.M Nr. 894, datë 04.11.2015 ”Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Në vijim të korrespondencës sonë ju kemi informuar me shkresën Nr 24495/2 prot datë 07.07.2021”.*

Sjellim në vëmendjen tuaj se në analizë të përmbajtjes të shkresës së sipërcituar Nr. 24495/2 prot., datë 07.07.2021, (me tonën K3/H3-22 prot., datë 30.08.2021), që ju referoni sa sipër, rezulton se është dhënë një përshkrim në mënyrë kronologjike i rastit, por siç e kemi shpjeguar edhe më lart nuk kanë marrë përgjigje të gjitha elementët e kërkimeve tona të pasqyruara në pyetjet e formuluar në shkresat tona të sipërcituara , të cilat janë dërguar pranë IMT-së, Bashkisë Tiranë.

Veç sa sipër , gjithashtu sjellim në vëmendjen tuaj se edhe në këtë rast përgjigja e dërguar nga ana juaj **nuk ka patur në konsideratë edhe qëndrimin e dhënë nga ana e IKMT-së, (IMT-së Bashkisë Tiranë), me shkresën Nr 2599 prot,**

datë 30.07.2021, (me tonën Nr K3/H3-20 prot., datë 06.08.2021), dhe Nr. K3/3H3-25 prot., datë 15.10.2021 në të cilën ndër të tjera citohet se: *Referuar shkresës së sipërcituar drejtuar njëkohësisht edhe IMT, rezulton se ju jeni në dijeni për rastin dhe keni mbajtur procedurë ligjore përkatësisht proces-verbal konstatimi Nr 4032 datë 26.03.2021 dhe vendim dënimi me gjobë Nr 338 datë 02.04.2021, por deri më 16.06.2021 shkallët rezultojnë të pahequra. Sa më sipër në zbatim të përgjegjësiave dhe detyrave që ngarkon Ligji Nr 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme” (i ndryshuar), VKM Nr 894 datë 04.11.2015 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të Territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore , Ligjin Nr 107 datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e Territorit” i ndryshuar, V.K.M Nr. 408 datë 13.05.2015, ”Për miratimin e rregullores së Zhvillimit të Territorit (i ndryshuar), Ka kërkuar informacion të plotë në lidhje me veprimet e kryera si dhe zbatimin e ligjshmërisë deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje . Në Përfundim për çfarë konkludohet brenda afateve të përcaktuara në nenin 5 të Ligjit Nr 9780 datë 16.07.2007 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme “ i ndryshuar, të dërgohet informacion pranë Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit dhe Avokatit të Popullit.*

Në këtë kontekst, është mëse evidente që kthimi i përgjigjes së IMT-së , Bashkisë Tiranë, nuk ka dhënë asnjë informacion si për IKMT-në, ashtu edhe për institucionin e Avokatit të Popullit në lidhje me veprimet e kryera nga ana e IMT-së, Bashkisë Tiranë, në zbatimin e ligjshmërisë (nga data 16.06.2021, ku shkallët rezultonin ende të pahequra), e në vijim deri në zgjidhjen përfundimtare të kësaj çështje, informacion ky i cili është kërkuar në mënyrë eksplicite nga IKMT-ja .

Vlerësimi i Avokatit të Popullit, konkluzione dhe rekomandime:

Bazuar në kuadrin ligjor që rregullon legjislacionin përkatës “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit është një nga autoritetet e inspektimit të ndërtimit, i cili ushtron përgjegjësinë e tij në drejtim të kontrollit të territorit, si dhe zbatimin e ligjshmërisë së standarteve teknike e kushteve zhvillimore në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit dhe të atyre të parashikuara shprehimisht në ligje të tjera.

Me qëllim mbrojtjen e territorit dhe parandalimin e punimeve dhe të ndërtimeve të paligjshme nga ana IMT-së, kryhen inspektimet përkatëse duke bërë verifikimin e respektimit të kërkesave ligjore, në përputhje me ligjin Nr. 9780, datë 16.07.2007, “*Për inspektimin e ndërtimit*” të ndryshuar , aktet nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, dhe të legjislacionit të zbatueshëm për inspektimin e Ndërtimit në Republikën e Shqipërisë”.

Gjatë ushtrimit të funksioneve të tij dhe në përmbushje të përgjegjësisë të parashikuara në ligj është detyrë e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit marrja e masave konkrete administrative, si : vendosja e gjobës, pezullimi i punimeve, prishja e ndërtimit të paligjshëm, përgatitja e kallëzimit penal për veprat penale që mund të konstatojë gjatë ushtrimit të kontrollit, si dhe paraqitjen e tij pranë organeve përgjegjëse sipas legjislacionit në fuqi.

Lidhur me rastin në fjalë nga ana IMT-së është konstatuar kundërvajtja administrative “*zgjerimi i dritares dhe vendosja e një shkalle me konstruksion metalik të çmontueshëm pa u pajisur me leje përkatëse*, dhe është mbajtur proces-verbali i konstatimit Nr 4032 datë 26.03.2021, si dhe vendim dënimi me gjobë Nr 338 datë 02.04.2021, në masën 50 000 (pesëdhjetë) mijë lekë për kundërvajtësin N.N. Ashtu siç rezulton edhe nga fotot e objektit është mëse e dukshme që kundërvajtësi jo vetëm ka bërë zgjerimin e dritares por e ka kthyer

atë në derë pa u pajisur me leje përkatëse, fakt ky i cili nuk është evidentuar nga ana juaj në proces-verbalin e konstatimit të kundërvajtjes datë 26.03.2021.

Edhe nga shkresa Nr K3/3H3-19 prot., datë 20.07.2021 “*dërgim informacioni*”, e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike, Drejtoria e Investimeve të Punëve Publike ka rezultuar në mënyrë të qartë se shkallët e ndërtuara me konstruksion metalik nuk janë realizuar nga projekti i Bashkisë, pasi nuk kanë qenë pjesë e tij. Unifikimi i shkallëve që parashikohej nga ky projekt realizohej me beton dhe pllaka guri si këmbë shkelje.

Vlerësojmë se masat e marra prej këtij Inspektoriatit nuk i janë përgjigjur situatës ndërtimore të paligjshme të zhvilluar në terren. Kështu edhe pse nga data 26.03.2021, nga ana IMT-së, Bashkisë Tiranë, është konstatuar kundërvajtja për kryerjen e punimeve pa leje lidhur me zgjerimin e dritares, si dhe vendosjen pa leje të shkallëve me konstruksion metalik të çmontueshëm, rezulton se në ushtrim të detyrës tuaj, akoma nuk është zgjidhur kjo situatë paligjshmërie.

Gjatë veprimtarisë administrative e IMT-së, Bashkisë Tiranë, lidhur me rastin janë kryer veprime ose mosveprime që bien ndesh me frymën e parimeve të Kodit të Procedures Administrative , e konkretisht konstatojmë se:

Është cënuar parimi i ligjshmërisë i cili parashikohet në nenin 4 të Kodit të Procedurës Administrative, ku parashikohet se: “Organet publike ushtrojnë veprimtarinë e tyre në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me marrëveshjet ndërkombëtare të ratifikuara dhe legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, brenda kufijve të kompetencave të tyre dhe në përputhje me qëllimin për të cilin janë dhënë këto kompetenca.

Parimi i drejtësisë dhe i paanësisë i cili parashikohet në nenin 13 të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: Në ushtrimin e funksioneve të tij,

organi publik trajton në mënyrë të drejtë dhe të paanshme të gjitha subjektet me të cilat krijon marrëdhënie.

Parimi i objektivitetit, i cili sanksionohet në nenin 14 të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se: "Gjatë ushtrimit të veprimtarisë administrative, organet publike marrin në konsideratë dhe i japin rëndësinë e duhur të gjitha kushteve, të dhënave dhe provave që lidhen me procedurën administrative."

Parimi i deburokratizimit dhe i efikasitetit, i cili parashikohet në nenin 18/2 të Kodit të Procedurës Administrative ku parashikohet se : "Procedura administrative zhvillohet sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se afati kohor i parashikuar me ligj për të, me sa më pak kosto për organin publik dhe për palët, në mënyrë që të arrihet çfarë është e nevojshme për një rezultat të ligjshëm.

Gjatë hetimit administrativ ka rezultuar se veprimtaria administrative e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Tiranë, në procesin e trajtimit të rastit të ndërtimit të paligjshëm të kryer në *Bulevardi: "Zogu i Parë", pallati 64, shkalla 1, kati I rë , Njësia Bashkiake Nr 9, Tiranë*, nuk është zhvilluar në përputhje me parimet ligjore mbi bazë të të cilit është normuar veprimtaria e këtij organi. Ushtrimi i detyrave sikurse parashikuar në ligj, është i detyrueshëm në këtë situatë në të cilën ndodhet çështja e prezantuar, pasi nga ana e Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Tiranë, nuk është respektuar dhe nuk respektohet detyrimi për ushtrimin e përgjegjësisë ligjore e detyrave specifike të sanksionuara në ligj, që kanë për synim të parandalojnë dhe të prishin ndërtimet pa leje të organeve kompetente përkatëse. Në lidhje me procedurën e ndjekur gjatë hetimit administrativ të rastit IMT-ja, Bashkisë Tiranë, ka vepruar në kundërshtim me ligjin Nr.107/2014, i ndryshuar me ligjin Nr 73/2015, i ndryshuar

me ligjin Nr 28/2017, *Për Planifikimin e zhvillimit të territorit*”, të ndryshuar, e në mënyrë eksplicite me nenin 52 të tij *“kundërvajtjet administrative”*, Konkretisht :

a) Nuk ka vepruar konform Nenit 52/e i cili parashikon se: *“kryerja e punimeve pa leje dënohet me gjobë të barabartë me vlerën e punimeve të kryera pa leje, por në çdo rast jo më pak se 500 000 lekë, dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera .”*

Nenit 52/6 i cili parashikon se : *“Vendimi për prishjen e ndërtimeve përmban edhe detyrimin e prishjes së menjëhershme të ndërtimit dhe kthimin e truallit në gjendjen e mëparshme me shpenzimet e kundërvajtësit”*.

d) Neni 52/7 i cili parashikon se : *“Për shkeljet që përbëjnë vepër penale, autoritetet e inspektimit krahas dënimit për kundërvajtjet e konstatuara, sipas këtij neni, bëjnë menjëherë kallzim për ndjekje penale.”*¹

b) Nuk ka vepruar konform V.K.M-së Nr. 894, datë 4.11.2015 *“Për unifikimin e procedurave të kontrollit të Territorit nga Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit dhe ai i Njesisë Vendore”*, e në mënyrë specifike me pikat 6 dhe 7 të këtij vendimi. Konkretisht në pikën 6 të tij është parashikuar se: *“Vendimi i dënimit me gjobë merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit e disiplinimit të punimeve në ndërtim dhe nuk pengon marrjen e një vendimi të dytë për pezullimin e punimeve në ndërtim apo të vendimit për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm. Vendimi i dënimit me gjobë mbahet sipas formës së parashikuar në aneksin shoqërues të vendimit. Ndërsa në pikën 7 të tij është parashikuar se : “Vendimi për prishjen e ndërtimit të kundërligjshëm merret në përputhje me legjislacionin në fuqi në*

¹ Neni 199/a Kodit Penal , Ndërtimi i paligjshëm :

“ Ndërtimi i kryer pa leje, në shkelje të rëndë të lejes ose në kushtet e një lejeje të shfuqizuar në tokën në pronësi të vet, dënohet me burgim deri në një vit.

Po kjo vepër, e kryer për plotësimin e nevojave për strehim sipas ligjit, dënohet me gjobë ose me burgim deri në tre muaj.

Po kjo vepër, e kryer në tokën publike ose shtetërore apo në tokën e tjetrit, dënohet me burgim nga një deri në pesë vjet.

Po kjo vepër, kur ka sjellë pasoja të rënda apo e kryer për qëllime fitimi, dënohet me burgim nga tre deri në tetë vjet.

fushën e planifikimit, zhvillimit, mbrojtjes së territorit, si dhe në të gjitha rastet kur nuk respektohet vendimi i pezullimit të punimeve në ndërtim, nuk plotësohet dokumentacioni teknik e ligjor dhe kur ka parregullsi në zbatimin e punimeve në objekt, brenda afatit kohor të parashikuar në vendimin përkatës. Vendimi për prishje shoqërohet me vendimet e dënimit me gjobë dhe për kundërvajtësin përgatitet kallëzimi penal, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 3, pika 21 e Ligjit Nr 107/2014 “Për Planifikimin e zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, ka trajtuar nocionin juridik të ndërtimit pa leje. Kjo dispozitë parashikon se: “ndërtim/punim pa leje janë ato procese dhe/ose objekte ndërtimore të kryera në mungesë së lejes së ndërtimit, deklaratës paraprake për kryerjen e punimeve ose të kryera në kushtet e një lejeje të shfuqizuar. Po kështu edhe në Nenin 5/ f , të Ligjit Nr. 9780, datë 16.7.2007, i ndryshuar me ligjin Nr.10 240, datë 25.2.2010, Ligjin Nr.10 323, datë 23.9.2010, Ligjin Nr. 23/2013, datë 14.02.2013, Ligjin Nr. 183/2014, datë 24.12.2014 “Për inspektimin dhe mbrojtjen e Territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, është parashikuar se: *Fjala "ndërtim/punim", sipas këtij neni, përfshin ato procese dhe/ose objekte ndërtimore që ndërtohen ose instalohen në territor, me vendosje të palëvizshme apo të përkohshme, që zhvillohen nën dhe/ose mbi tokë, çdo veprim/proces ndërtimi, gjurmimi, prishjeje, zgjerimi, riparimi, rinovimi, si dhe çdo ndërhyrje tjetër në territor ose strukturë dhe i referohet gjendjes aktuale, vëllimit të punimeve të kryera, përfshirë dhe/ose rrethime të kundërligjshme në çastin e ushtrimit të inspektimit.*

Evidentojmë faktin se gjatë hetimit administrativ lidhur me rastin ka rezultuar se ka patur veprime apo mosveprime të të IMT-së, Bashkisë Tiranë, të cilat nuk kanë qenë në korelacion me kryerjen e detyrave funksionale dhe në përputhje me kompetencat e këtij organi, sikurse janë të përcaktuara me ligj, me akt nënligjor,

si dhe veprimet administrative të nxjerra në zbatim të tyre, ushtrimi i të cilave është i detyrueshëm² për të.

IMT-ja, Bashkisë Tiranë, nuk ka ushtruar rregullisht përgjegjësitë e saj pasi në nenin 52/e në mënyrë taksative është parashikuar që krahas gjobës duhej të dënohej kundërvajtësi dhe me prishje ose konfiskim për interes publik të punimeve të kryera, si dhe të bënte menjëherë kallzim për ndjekje penale për ndërtim të paligjshëm konform nenit 199/a e Kodit Penal.

Në kuptim të ligjit Nr 9780 datë 16.07.2007, të ndryshuar, “Për inspektimin dhe mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme”, i cili ka për qëllim ndër të tjera mbrojtjen e territorit nga ndërtimet e kundërligjshme, ka rezultuar se : Duke zbatuar jo në mënyrë korrekte ligjin dhe duke u mjaftuar vetëm me vendosjen e gjobës, dhe duke mos urdhëruar krahas saj edhe prishjen e punimeve pa leje ose konfiskimin e shkallëve, gjendemi në kushtet që pavarësisht konstatimit të punimeve pa leje më datë 26.03.2021, si dhe mbajtjes së proçes-verbalit të konstatimit Nr 4032 datë 26.03.2021, si dhe vendim dënimit me gjobë Nr 338 datë 02.04.2021, aktualisht ka rezultuar që ato nuk e kanë zgjidhur çështjen në thelb, pasi nuk e kanë rikthyer situatën në kushtet e ligjshmërisë. Kështu punimet e kryera pa leje nga autoriteti kompetent, përkatësisht zgjerimi i dritares dhe vendosja e një shkalle me konstruksion metalik të çmontueshëm, të cilat kanë zënë hapësirën publike si dhe dritaren e bodrumit të ankueses, në kundërshtim me dispozitat ligjore, vazhdojnë të jenë në gjendjen e konstatuar nga IMT-ja më datë 26.03.2021. Nga argumentimi sa sipër është mëse evidente që marrja e këtij sanksioni nuk është efektiv lidhur me rastin dhe aktet e mbajtura kanë mbetur thjesht shkresa të cilat në thelb nuk ka sjellë ndryshim të situatës faktike.

² Neni 22/2 i Kodit të Procedurës Administrative.

Në vijim të analizës sonë, theksojmë se : Në kuadër të bashkëpunimit gjatë procesit të zhvillimit të hetimit administrativ, evidentojmë faktin se gjatë komunikimit institucional me IMT- në, Bashkia Tiranë, ka rezultuar se edhe pse janë kthyer përgjigje në aspektin formal lidhur me kërkesat për shpjegime apo informacion të dërguara nga Avokati i Popullit , në vlerësimin tonë ato nuk mund të konsiderohen të tilla në aspektin substancial. Kështu në përgjigjet e dhëna nga IMT-ja, është mjaftuar vetëm në përmendjen e akteve të mbajtura prej Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Tiranë, si dhe referencat gjenerike ligjore që rregullojnë veprimtarinë e kësaj organi. Por sqarojmë se nuk ka dhënë asnjë shpjegim të arsyetuar që të sqarojë se çfarë veprimesh, mosveprimesh apo masash konkrete ka ndërmarrë në përmbushje të detyrave të saj funksionale për të siguruar detyrimin e saj ligjor lidhur me zbatimin e ligjit në lidhje me rastin, Gjithashtu nuk i ka kthyer përgjigje në mënyrë të përsëritur, çështjeve të specifikuar për informacion nga ana Institucionit të Avokatit të Popullit në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të cilat kanë rëndësi për zgjidhjen e drejtë të çështjes.

Duke e konsideruar refuzues qëndrimin e mbajtur prej Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Bashkisë Tiranë, në më shumë se në një rast, çojmë se ky qëndrim ka cënuar një ndër parimet më të rëndësishme, parimin e bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike. Evidentojmë gjithashtu faktin se *Inspektorati Mbrojtjes së Territorit Bashkisë Tiranë*, nuk i ka dërguar as Inspektoratit Ndërtimor e Urbanistik Kombëtar, konform nenit 5 pika “e” ligjit Nr.9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, informacionin e plotë në lidhje me veprimet e kryera si dhe për zbatimin e ligjshmërisë deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes, edhe pse kjo është kërkuar në mënyrë të përsëritur prej tij në shkresat Nr K3/H3-15 prot., datë 05.07.2021 dhe Nr. K3/H3-20 prot., datë 06.08.2021.

Parimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve të administratës publike, është sanksionuar si në parimet e Kodit të Proçedurës Administrative, ashtu edhe në ligjin Nr. 90/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e organeve të administratës shtetërore". Neni 3 i këtij ligji përcakton se: *1. Administrata shtetërore organizohet dhe funksionon sipas parimeve të: unitetit dhe hierarkisë; llogaridhënies; dekoncentrimit; qartësisë në përcaktimin dhe shpërndarjen e përgjegjësisë; ekonomisë, efikasitetit dhe efektivitetit, si dhe bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të administratës shtetërore. Sipas parimit të bashkëpunimit, organet, institucionet dhe njësitë administrative, si dhe nëpunësit publikë, në të gjitha nivelet e administratës, bashkëpunojnë ndërmjet tyre, si dhe me organet e institucioneve të pavarura, për arritjen e objektivave ligjorë që u janë besuar, në përputhje me ligjin".*

Në këtë kontekst, sqarojmë se bashkëpunimi gjatë hetimit administrativ është i lidhur ngushtësisht me parimin e transparencës dhe atë të llogaridhënies. Organet e administratës publike janë të detyruara të bashkëpunojnë për të mbështetur organin publik që kryen hetimin administrativ në funksion të përcaktimit të fakteve dhe rrethanave të çështjes. Transparenca dhe llogaridhënia janë dy nga parimet kryesore të mirëqeverisjes në administratën publike. Misioni i institucionit të Avokatit të Popullit në këtë drejtim është të kontribuojë në transparencën dhe llogaridhënien e organeve publike sa i përket ushtrimit të veprimtarisë administrative nga ana e tyre.

Mungesa e informacionit dhe dokumentacionit, si dhe dërgimi i përgjigjeve të pjesshme, apo tej afatit të përcaktuar dhe atij të arsyeshëm ligjor, sjell zvarritjen e procesit administrativ dhe mohimin e të drejtës së qytetarëve për të gëzuar efektivisht të drejtat e tyre kushtetuese dhe për të përdorur mekanizmat kushtetues për garantimin e tyre. Kjo gjithashtu minon besimin e qytetarëve tek shteti i së

drejtës dhe administrata shtetërore ndërkohë që të gjitha përpjekjet në nivel evropian por edhe të Këshillit të Evropës janë të drejtuara për nga ruajtja e besimit të publikut dhe përmirësimi i këtij indikator.

Në këtë këndvështrim, duam t'ju kujtojmë përkufizimin tashmë të pranuar nga Parlamenti Europian, në lidhje me keqadministrimin nga ana e organeve të administratës publike, sipas të cilit: *“Keqadministrimi ndodh kur një organ publik, nuk vepron në përputhje me një rregull apo princip, i cili është i detyrueshëm për të”*.

Sa më sipër, bazuar në neni 63/3 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë në të cilin parashikohet se : *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur konstaton shkelje të të drejtave dhe lirive nga administrata publike”*, si dhe nenin 21/b të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999, *“Për Avokatin e Popullit ”* i ndryshuar, në të cilin parashikohet se :
“ Pas përfundimit të hetimeve, Avokati i Popullit kryen këto veprime,
b) paraqet rekomandime për venien ne vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që, sipas tij, ka shkaktuar shkelje të të drejtave dhe lirive”,
c) Avokati i Popullit paraqet rekomandime për marrje masash për vënien në vend të së drejtës së shkelur tek organi administrativ që ka shkaktuar shkeljen”;

REKOMANDOJMË:

- Marrjen e masave për sigurimin e respektimit të normave, standarteve dhe të legjislacionit në procesin e ushtrimit të përgjegjësisë e kontrollit mbi ndërtimin pa leje, të ndodhur në Bulevardi: “Zogu i Parë”, pallati 64, shkalla 1, kati I rë , Tiranë.

- Fillimin dhe përfundimin e procedurës administrative mbi ndërtimin e paligjshëm të ndodhur në Bulevardi: “Zogu i Parë”, pallati 64, shkalla 1, kati I rë, Tiranë, me qëllim rikthimin e situatës në kushtet e ligjshmërisë .
- Analizimin e këtij rasti nga strukturat përkatëse dhe marrjen e masave disiplinore për punonjësit që nuk kanë zbatuar legjislacionin lidhur me inspektimin, verifikimin, kontrollin dhe zbatimin e dispozitave të ligjit Nr. 9780, datë 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, të ndryshuar, dhe të akteve nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, si dhe të legjislacionit në fushën e planifikimit dhe zhvillimit të territorit, dhe të kontrollit të disiplinimeve të punimeve në ndërtim, duke identifikuar shkaqet e dështimit nga ana e IMT-së, Bashkisë Tiranë, në ushtrim të përgjegjësisë dhe të detyrës ligjore, mbi ndërtimin pa leje të ndodhur në Bulevardi: “Zogu i Parë”, pallati 64, shkalla 1, kati I rë , Tiranë.
- Marrjen e masave përkatëse për të adresuar mungesën e komunikimit korrekt me institucionin e Avokatit të Popullit sa i përket kërkesave për informacion, në lidhje me të cilat përgjigjet kanë rezultuar me përmbajtje të paplota në disa aspekte.
- Marrjen e masave të nevojshme nga strukturat përkatëse për bashkëpunimin, bashkërendimin dhe bashkëveprimin e punës në institucionin që ju drejtoni me qëllim mospërsëritjen e këtyre shkeljeve në të ardhmen.
- Konform nenit 21/b të ligjit Nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, paraqitja e këtij rekomandimi pezullon aktet apo veprimet e paligjshme apo të parregullta deri në shqyrtimin e këtij rekomandimi dhe dhënien e përgjigjes Avokatit të Popullit.
- Në zbatim të nenit 22 të Ligjit Nr.8454, datë 04.02.1999, “ Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar, brenda 30 ditësh nga marrja e këtij rekomandimi lutemi të na vini në dijeni mbi qëndrimin tuaj ndaj këtij rekomandimi si dhe masat e marra për rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Bashkëlidhur ju dërgojmë:

Foto: 6 (gjashtë) copë .

KOMISIONERI

Prof.Asoc.Dr. Erjona BANA (CANAJ)

d.v